




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 29.09.2020, parashtruar nga subjekti në procedurë : “ AOME “sh.p.k. me seli në Prishtinë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 05.10.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e Eliminuar të subjektit në procedurë: “ AOME “sh.p.k. me seli në Prishtinë
2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 24.09.2020

A r s y e t i m

Organi Shqyrtues i Prokurimit,(më tej OSHP), në Vendimin e tij nr. 596/20 dt. 18.09.2020 në mes tjerash ka anuluar Njoftimin mbi Vendimin për Dhënie të Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit : Furnizimi me dru për ngrohje, me nr. prok. 644-20-2120-1-1-1 Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 022 – 111, ndërsa lënda është kthyer në rivlerësim.

Në zbatim të Vendimit të OSHP-së, bazuar dhe në nenin 59 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues (më tej A.K.) ka zbatuar procedurën e Ri-Vlerësimit të tenderëve të pranuar në këtë aktivitet të prokurimit, duke ardhur në konstatimet si në vijim.

Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 (**tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 24.09.2020 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik: “ **Milaim Bejta B.I. “emri i biznesit “ Bushgegu 89 “emri tregtar, me seli në Prishtinë** është marrë, në mes tjerash, edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Më tej A.K., nga procesi i rivlerësimit, mbi bazën dhe të dëshmime të dorëzuara nga O.E., padiskutueshëm ka konstatuar se tenderi i O.E. “ AOME “sh.p.k. (në tekstin e mëtejshëm Ankuesi) është i

papërgjegjshëm për arsye se dëshmitë, siç është përshkruar në Seksionin II. Fleta e Të Dhënave të Tenderit (FTD) të Dosjes së Tenderit, Kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe / ose profesional, neni 9.1 lidhur me 9.2, pika 1, tregojnë arsyeshëm se nuk i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit teknik dhe / ose profesional të saktësuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin e Kontratës, që nënkupton se : Ankuesi, gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë, nuk ka realizuar – përmbushur kontrata të furnizimit me dru që kapin vlerën financiare min. 160.000,00€.

Vlera e kontratave të realizuara nga Ankuesi, në tre vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë, të dëshmuara – dorëzuara arrijnë shumën prej 114.995,40€, që nuk përmbushë Kërkesën e A.K. të saktësuar në FTD – kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale, nenin 9.1 lidhur me 9.2 pika 1, citat : Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të furnizimeve të njëjta, në vlerë minimale prej 160.000,00 Euro, në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në rast Grupi të OE, lideri i Grupit duhet ti ketë 60 % të vlerës së referencave” mbarim i citatit.

Në konstatim të njëjtë, lidhur me kapacitetin teknik dhe / ose profesional të Ankuesit, ka ardhur edhe Eksperti Shqyrtues në Ekspertizën e tij Nr. 596/20 dt. 04.09.2020 pika 7 , citat : “ Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në Kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë, , ku A.K. ka kërkuar kontrata të furnizimeve të njëjta dhe njëherit duke u bazuar në Listën e kontratave të përfunduar, të ofruar nga i rekomanduari për dhënie të kontratës, vlerëson se i njëjti nuk e ka plotësuar Kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë, lidhur me kontratat dhe referencat “ mbarim citati.

Po ashtu dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së, në Vendimin e tij nr. 596/20 dt. 18.09.2020 duke ardhur në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, nga ana e A.K. nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, ka obliguar A.K. që gjatë procesit të Ri-Vlerësimit të tenderëve – ofertave t’i përmbahet në detaje të gjitha Kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë.

Mbi këto premisa dhe konkludime të organeve kompetente, edhe A.K. gjatë procesit të Ri-vlerësimit ka ardhur në përfundimin se, duke mos përmbushur Kërkesat e A.K. të saktësuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, Ankuesi ka bërë devijim thelbësorë nga kërkesat e përcaktuara dhe, për rrjedhojë tenderi i Ankuesit, në pajtim me dispozitat e nenit 59 të LPP-së, është vlerësuar si i papërgjegjshëm andaj si i tillë është refuzuar.

Në fund, A.K. vlerëson se Vendimi për ta refuzuar si të pabazuar Kërkesën për Rishqyrtim të parashtuar nga Ankuesi është marrë bazuar në rezultatet e konstatuara nga procesi i Ri-Vlerësimit përkatësisht nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve si dhe mbi bazën e dispozitave të nenit 59 të LPP-së lidhur me nenin 39.8 të RRUOPP. Më tej A.K. vlerëson se, bazuar në procedurën e zbatuar dhe në argumentimin si në shkresat e lëndës, me asnjë element nuk u vërtetua se A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së dhe / ose Rregullat RUOPP.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Kundër këtij vendimi, parashtuesi i Kërkesës për rishqyrtim mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 022/2020 - datë 05/10/2020

Aktvendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtorja për Prokurim Publik


Xhafer Islami – U.D. ZLP